

KUSHTET DHE RREGULLAT

1. HYRJE

MONETA SH.P.K., përmes rrjetit të saj të agjentëve, ofron shërbimin e transferit të parave dhe pagesave. Është e licencuar dhe mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe është e autorizuar nga MoneyGram Payment Systems, Inc. (në tekstin e mëtejshëm: "MPSI") një filial i MoneyGram International, Inc. (në tekstin e mëtejshëm: "MoneyGram International") për të ofruar shërbime të transferimit të parave përmes rrjetit të agjentëve të saj.

2. TRANSAKSIONI I DËRGESËS

2.1 Përmes transaksionit të Dërgesës ju mund t'i dërgoni para personit të përmendur (pranuesit) në formular: (a) për të pranuar para në një lokacion të MoneyGram (shërbimi ynë "cash to cash"); ose (b) për të pranuar në llogarinë e tij/saj bankare ose një lloj tjetër, llogari fizike apo virtuale, duke përfshirë mobile wallet (shërbimi ynë "cash to account"). Këto kushte vlejnë për të dy shërbimet, përveç aty ku themi se zbatohet njëra prej tyre.

2.2 Pranuesi mund t'i pranohet paratë vetëm në vendin e marrjes, të deklaruar në formular. Pasi që agjenti të procesojë këtë transaksion dhe t'i ketë marrë paratë tuaja, pranuesi brenda disa minutave mund t'i marrë paratë në çdo lokacion të MoneyGram-it në shtetin e caktuar, në para të gatshme, në valutën e treguar në formular. Ne nuk do të kontaktojmë pranuesin kur paratë të jenë gati për t'u tërhequr, këtë duhet ta bëni ju.

2.3 Transferi procesohet brenda 10 minutash. Nëse klienti brenda 45 ditësh nuk i tërheq paratë, transferi bllokohet dhe për aktivizim duhet të kontaktohet MoneyGram-i. Transferi skadon pas 90 ditësh dhe ne nuk marrim asnjë përgjegjësi.

2.4 Ju nuk duhet t'i jepni numrin e referencës askujt tjetër përveç pranuesit dhe duhet të bëni gjithçka që është e mundur që të siguroheni që askush tjetër mos ta mësojë atë.

2.5 Ka kufizime se sa para mund të dërgoni. Agjenti, sipas nevojës, do t'iu tregojë se cilat janë ato.

2.6 Ne nuk i ofrojmë shërbimet tona në të gjitha shtetet. Mund të na telefononi, të vizitoni faqen tonë të internetit ose ti kërkonit agjentit për të mësuar disponueshmërinë e shërbimeve tona, adresat dhe oraret e hapjes së lokacioneve që ofrojnë shërbimin e MoneyGram.

3. TRANSAKSIONI I TËRHEQJES

3.1 Transaksioni i tërheqjes ju lejon të pranoni paratë që një dërgues i ka nisur, shumën e saktësuar nga dërguesi mund ta pranoni në një lokacion të Moneta-s, ne nuk do t'ju tarifojmë për këtë shërbim. Vini re se përmes shërbimit tonë ju duhet të pranoni para si një person i njohur nga dërguesi dhe nuk duhet të pranoni para si një pagesë komerciale.

3.2 Agjenti do të kërkojë numrin e referencës së transferit (të cilin mund ta merrni nga dërguesi).

3.3 Ju duhet t'i siguronit agjentit një mjet të identifikimit të vlefshëm.

4. NËNSHKRIMI I FORMULARIT

4.1 Ju duhet të nënshkruani formularin e DËRGESËS ose TËRHEQJES dhe të siguroheni që të gjitha fushat të jenë plotësuar plotësisht dhe me saktësi. Nëse nuk e bëni këtë, ne mund të mos jemi në gjendje ta përfundojmë transaksionin. Ju duhet të na telefononi nëse ndonjë nga informacionet që jepni ndryshon përpara se marrësi të pranohet paratë.

4.2 Kontakti ynë është ueb faqja www.monetaks.com ose www.moneygram.com, dhe adresa jonë elektronike moneta@monetaks.com ose customerservice@moneygram.com.

5. FATURIMI DHE KURSET E KËMBIMIT

Ju duhet të paguani provizionin e treguar në formular dhe nuk do të ngarkoheni me asnjë tarifë tjetër shtesë. Ju mund të dërgoni para vetëm në një monedhë ose valutë të caktuar. Agjenti do t'ju tregojë nëse një valutë është e disponueshme në një vend të caktuar, në vendin e pranimit dhe (nëse është e ndryshme nga valuta në të cilën ju na paguani) cili kurs i këmbimit do të aplikohet. Valuta dhe kursi i këmbimit për të cilën jeni përcaktuar dhe shuma e konvertuar, do të tregohen në formular.

6. KUFIZIMET E TRANSFEREVE

6.1 Ne mund të refuzojmë t'i dërgojmë paratë ose të refuzojmë që ti pranoni ato nëse, me arsye, besojmë se duke vepruar kështu: (a) ne mund të shkelim ndonjë ligj, rregullore, kod ose detyrë tjetër që vlen për ne; (b) mund t'i ekspozohemi ndonjë veprimi të qeverisë ose rregullatorit; ose (c) dërgesa ose pranimi i parave mund të lidhet me veprimtari mashtruese ose të paligjshme.

6.2 Mund të na telefononi për t'ju treguar (përveç rasteve kur ligji nuk na lejon) arsyet e refuzimit tonë si dhe mund të korrigjoni gabimet që kanë çuar deri në refuzimin tonë. Nëse dërguesi dëshiron (dhe ligji e lejon), ose nëse ligji e kërkon, ne do t'ia kthejmë paratë dërguesit.

7. ANULIMI DHE RIMBURSIMI I TRANSFERIT

Ne mund ta anulojmë transferin me kërkesën tuaj para se marrësi t'i tërheqë paratë. Ju duhet të bëni kërkesë tek agjenti ku ju e keni bërë dërgesën. Ne do të veprojme menjëherë ndaj kërkesës tuaj, por ky proces mund të zgjasë deri në 30 ditë.

8. KUSHT SHITESË PËR TRANSFERIMIN E PARAVE NË LLOGARI

Ne do t'i dërgojmë paratë në llogarinë bankare ose çdo llogari tjetër fizike ose virtuale të cilën ju e specifikoni në formular. Për informacion se kur do të kreditohet një pagesë në një llogari të tillë, duhet të kontaktoni bankën e pranuesit ose ofruesin përkatës të shërbimit të llogarisë. Banka e pranuesit ose ofruesi përkatës i shërbimit të llogarisë mund të aplikojë tarifën e veta për transferin, të cilat nuk na përfshijnë ne.

9. PËRGJEGJËSIA JONË

9.1 Ne nuk do të mbajmë përgjegjësi nëse ne e shkelim këtë marrëveshje për shkak të: (a) rrethanave jonormale dhe të paparashikueshme të cilat janë jashtë kontrollit tonë pavarësisht përpjekjeve tona për ta bërë të kundërtën - kjo mund të përfshijë, për shembull: vonesa ose dështime të shkaktuara nga veprime industriale, probleme me një sistem ose rrjet tjetër, prishje mekanike ose dështime në përpunimin e të dhënave; ose (b) detyrimet tona sipas ligjeve në fuqi, të cilave mund t'u nënshtrohemi.

9.2 Ne nuk jemi përgjegjës ndaj jush për më shumë se shuma e parave që dërgoni dhe tarifa jonë. Ne nuk do të jemi përgjegjës për asnjë humbje aksidentale, indirekte ose pasuese, ose kosto që ju mund të vuani, ose siç është bërë kjo marrëveshje me ju si konsumator, asnjë humbje biznesi ose kosto (siç janë humbjet e përfitimeve të biznesit ose mundësive).

9.3 Shërbimi ynë është që ju t'i dërgoni para një personi fizik të cilin e njihni, jo të bëni një pagesë komerciale dhe nuk duhet të përdorni këtë shërbim për ato lloje transaksionesh. Ju gjithashtu duhet të ndiqni parajmërimet për mashtrimet e mundshme në formular. Nëse kërkonit të paguajmë dikë që rezulton se ju ka mashtruar, ose që nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij ndaj jush, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi.

10. KUSHTET E TJERA

Ne do t'i raportojmë transferet e parave tek çdo autoritet qeveritar nëse me ligj parashikohet një detyrim i tillë.

11. TË PËRGJITHSHME

Nëse transferi nuk është bërë siç duhet ose nuk arrin kurrë, ne mund të jemi përgjegjës ndaj dërguesit. Ne nuk do të jemi përgjegjës ndaj pranuesit, përveç se asgjë në këtë marrëveshje nuk e përjashton ose kufizon përgjegjësinë tonë deri në atë masë që ne nuk mund ta përjashtojmë ose kufizojmë me ligj.

12. MBROJTJA E TË DHËNAVE

12.1 MoneyGram dhe Moneta janë kontrollues të veçantë të të dhënave gjatë transaksionit, secila kompani ka detyrimet e veta për privatësinë, sipas ligjeve përkatëse.

12.2 Mbrojtja e të dhënave sipas detyrimeve të Moneta:

12.2.1 Moneta është e angazhuar për të mbrojtur privatësinë tuaj. Ne mund të përdorim të dhënat tuaja personale dhe detajet e transferimit tuaj, dhe t'i ruajmë ato në bazat tona të të dhënave, në mënyrë që t'ju ofrojmë juve dhe marrësit shërbime transferimi, për menaxhimin e biznesit tonë (duke përfshirë administrimin e marrëdhënieve tona të vazhdueshme me ju) dhe për kërkimin e tregut si lejohet nga ligji në fuqi.

12.2.2 Për qëllimet e mësipërme ne mund të ndajmë informacionin me MPSI. Ne nuk do ta ndajmë informacionin me askënd tjetër, përveç nëse ose siç kërkohet me ligj. Ne kemi praktika dhe procedurë sigurie për të kufizuar qasjen në informacionin personal sipas rastit.

12.2.3 Ju mund të kërkonit qasje në informacionin tuaj personal, të kërkonit që informacioni të korrigjohet ose përditësohet ose, për arsye legjitime, të kundërshtoni përpunimin e tij, duke na shkruar ose duke na dërguar me e-mail (kujdiesiperkliente@monetaks.com) ose duke na telefonuar.

12.2.4 Duke plotësuar dhe nënshkruar formularin, ju pajtohemi për marrjen, përdorimin dhe transferimin e të dhënave personale tuaja për qëllimet e mësipërme. Faqja jonë e internetit përcakton politikën tonë më të fundit për mbrojtjen e të dhënave dhe ne siç kërkohet nga ligji, do t'ju tregojmë për çdo ndryshim të kësaj politike.

12.3 Informacioni i MoneyGram sipas ligjeve të privatësisë

12.3.1 MPSI do të jetë kontrollues i të dhënave tuaja pasi ato të dhëna do të dorëzohen në sistemet e MPSI nga Moneta. MPSI do të ndajë të dhënat tuaja me partnerë ose kompani të tjera të MoneyGram brenda Grupit MoneyGram nëse është e nevojshme. Për shkak të rregullave të caktuara lokale për transferimin e parave, kundër pastrimit të parave etj., kompani të ndryshme mund të marrin të dhënat tuaja dhe t'i përpunojnë ato si kontrollues.

12.3.2 Lista e kontrollorëve brenda grupit MoneyGram është e disponueshme këtu <http://global.moneygram.com/controller-list>

12.3.3 Njoftimi i privatësisë së MoneyGram publikohet në faqen e internetit të MoneyGram <http://global.moneygram.com/privacy-notice> Një njoftim i tillë përmban informacion në lidhje me privatësinë, të drejtat, qëllimet e përpunimit, si dhe kontrolluesin për një juridiksion të caktuar.

13. ANKESAT

Ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë shërbimin më të mirë në çdo kohë. Në rast se jeni të pakënaqur me shërbimin tonë, ju lutemi, na kontaktoni sa më shpejt të jetë e mundur. Për detaje të plota të procedurës sonë të ankesave ose këshillave për mbrojtjen e klientëve, ose për të paraqitur një ankesë, mundeni:

a. Ta vizitoni webfaqen tonë www.monetaks.com ose www.moneygram.com dhe të shkruani drejtpërdrejt në formularin online.

b. Na telefononi në numrin pa pagesë (brenda Kosovës) 080050500.

c. Shkruani në email-in tonë kujdesiperklente@monetaks.com ose cosutomerservice@moneygram.com

d. Të na shkruani në: MONETA SH.P.K. Ndërtesa Illyria, Rruga Prishtinë - Graçanicë, Prishtinë 10060, Kosovë ose në: Customer Services Department, MoneyGram International, Resolution Assurance Department, Konstruktorska Business Centre; 13 Konstruktorska Street, Warsaw, Poland 02-673.